

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. __, datë __. __. 2019

PËR NDËRTHURJEN E PROGRAMEVE SOCIALE TË STREHIMIT ME SHËRBIMET SOCIALE TË PUNËSIMIT, ARSIMIMIT DHE KUJDESIT SHËNDETËSOR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 12 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, ministri i Financave dhe Ekonomisë, i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

UDHËZOJNË:

1. Ministrinë përgjegjëse për strehimin, punësimin, arsimimin dhe kujdesin shëndetësor caktojnë pika kontakti për këmbimin e informacioneve dhe mbajtjen e kontakteve me qëllim ndërveprimin në kuadër të zbatimit të programeve të strehimit social.
2. Në kuadër të këtij udhëzimi, dhe në përputhje me nenin 73 të ligjit nr. 22.2018 ‘Për strehimin social’ për krijimin e bazës së të dhënave në nivel vendor për strehimin social, njësitë e vetëqeverijes vendore caktojnë pika kontakti për këmbimin e informacioneve dhe mbajtjen e kontakteve me qëllim ndërveprimin në kuadër të zbatimit të programeve të strehimit social me ministrinë përgjegjëse për strehimin, punësimin, arsimimin dhe kujdesin shëndetësor.
3. Ministria përgjegjëse për strehimin është përgjegjëse për koordinimin e rrjetit të pikave të kontaktit i cili krijohet për të ndërlidhur ministrinë me njëra-tjetrën, si dhe ministrinë me personat që përfitojnë nga programet e strehimit social.
4. Pikat e kontaktit për personat që përfitojnë nga programet e strehimit social informojnë rrjetin sa herë paraqiten nevoja për punësim, arsimim, shërbime shëndetësore të personave që përfitojnë nga programet e strehimit social. Pikat e kontaktit për personat që përfitojnë nga programet e strehimit social ndërmarrin veprime të menjëhershme për adresimin e nevojave sipas fushave të përgjegjësisë të ministrisë që përfaqësojnë.
5. Pikat e kontaktit, në përputhje me programet e shërbimit për të cilat është përgjegjës institucioni përkatës sipas fushës së përgjegjësisë, përdorin bazën e të dhënave në nivel kombëtar dhe vendor të krijuara sipas nenit 72 dhe 73 të ligjit nr. 22.2018 ‘Për strehimin social’, sipas qasjes që ata kanë në to në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pikat e kontaktit përditësojnë këto baza të dhënash me të dhëna të përfitimit të personave që përfitojnë nga shërbimet për punësim, arsimim, dhe ato shëndetësore sipas përgjegjësive të tyre.

6. Ministrinë, sipas fushave të tyre të përgjegjësive, përmes institucioneve zbatuese si vijon, ndërmarrin veprimet si vijon:

6.1.Ministria përgjegjëse për programet sociale - Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH):

- a. Për rastet kur individët/familjet që përfitojnë nga programet e strehimit social janë/kanë persona me aftësi të kufizuara, SHSSH nëpërmjet Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar (KSHVAK) pas kryerjes së vlerësimit të aftësisë së kufizuar, sipas nevojave, përgatit rekomandimet për shërbime të strehimit social për personat me aftësi të kufizuar, duke u bazuar në:
 - nevojat e identifikuar sipas përbërjes familjare;
 - nevojat sipas moshës;
 - nevojat për banesa të specializuara për shkak të gjendjes shëndetësore dhe/ose aftësive ndryshe/të kufizuara;
 - qëllimet afatshkurtra dhe afatgjata të individit;
 - shërbimet ekzistuese në komunitetin ku banon personi.
- b. KSHVAK pajis individin me certifikatën e aftësisë së kufizuar e cila përmban rekomandimet për shërbime të strehimit social, pranë njësive të vetëqeverisjes vendore;
- c. KSHVAK cakton një përgjegjës për shkëmbimin e informacionit të nevojshëm me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ministrinë përgjegjëse për punësimin, si dhe Shërbimin Kombëtar të Punësimin, për çështje që lidhen me punësimin e personave me aftësi të kufizuar;
- d. SHSSH, në përputhje me legjisalcionin në fuqi, mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi edhe me subjekte jopublike apo agjenci private punësimi që ofrojnë shërbime të mbështetjes për shërbime të punësimin të mbrojtur, shërbime punësimi në komunitet, ndërmjetësim për punësim etj., për personat me aftësi të kufizuar;
- e. Pika e kontaktit për personat që përfitojnë nga programet e strehimit social në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ndjek mbarëvajtjen e angazhimeve të mësipërme deri në punësimin e individit, kur kjo është e mundur, sipas gjendjes së përcaktuar për personat me aftësi të kufizuar.

6.2.Ministria përgjegjëse për kujdesin shëndetësor – Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH):

- a. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë komunikon me FSDKSH për të caktuar të paktën një punonjës për ndjekjen e çështjeve të lidhura me përfituesit e programeve sociale të strehimit;
- b. FSDKSH nëpërmjet institucioneve shëndetësore mundëson zbatimin e rekomandimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe informimin e Pikës së kontaktit për personat që përfitojnë nga programet e strehimit social në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë si dhe administratorit shoqëror të njësive të vetëqeverisjes vendore ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin personi përfitues i një prej programeve të strehimit social;
- c. FSDKSH përcakton paketën higjienosanitare dhe mundëson shpërndarjen e saj për personat përfitues të strehimit social.

6.3. Ministria përgjegjëse për punësimin - Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP):

- a. SHKP cakton të paktën një punonjës përgjegjës për çështjet e lidhura me punësimin e personave që përfitojnë nga programet e strehimit social, me qëllim integrimin e tyre në tregun e punës përmes përfshirjes së tyre në njërin nga programet e mëposhtme:
 - Programi i Ndërmjetësimit për Punë,
 - Programi i Nxitjes së Punësimit,
 - Programi i Formimit Profesional,
 - Programi i Pagesës së Papunësisë,
 - Shërbimet migratore dhe imigratore.
- b. SHKP merr masa për të zbatuar nevojat e identifikuar të personave që përfshihen në programe sociale të strehimit dhe i trajton ato me prioritet edhe në respektim të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për punësimin e kategorive në nevojë, ose të kujdestarëve të tyre;
- c. Drejtoria Rajonale e SHKP raporton pranë Pikës së kontaktit për personat që përfitojnë nga programet e strehimit social në ministrinë përgjegjëse për arsimin ku banon personi që përfiton nga programet e strehimit social, rastet e trajtuara, ato të trajtuara me prioritet, rastet e dështuara të bashkëpunimit nga ana e përfituesve, rastet e suksesshme/të pasuksesshme të punësimit të personave që janë rekomanduar për shërbime punësimi dhe arsytet përkatëse.
- d. Punonjësit e Drejtorisë Rajonale të SHKP të ngarkuar për çështjet e aftësisë së kufizuar informojnë periodikisht në formë zyrtare Pikat e kontaktit për personat që përfitojnë nga programet e strehimit social në ministrinë përgjegjëse për strehimin mbi ofertat e punës që mund të jenë të përshtatshme për personat e përfshira në programet e strehimit social.
- e. Drejtoria e Përgjithshme e SHKP gjeneron informacione nga baza e të dhënave të SHKP- së Sistemi i Shërbimeve të Punësimit (SSHP) dhe informon Pikat e kontaktit për personat që përfitojnë nga programet e strehimit social në ministrinë përgjegjëse për strehimin me të dhëna për:
 - punëkërkesin,
 - punëdhënësin,
 - vende të lira pune.
- f. Të gjitha të dhënat e informuara hidhen nga Pika e kontaktit për personat që përfitojnë nga programet e strehimit social në ministrinë përgjegjëse për punësimin në bazën e të dhënave në nivel kombëtar dhe/ose bazën e të dhënave në nivel vendor për strehimin social. Pika e kontaktit për personat që përfitojnë nga programet e strehimit social në ministrinë përgjegjëse për strehimin në bazë të të dhënave në nivel kombëtar dhe/ose në nivel vendor kërkon informacion për çdo rast që rezulton të mos ketë marrë shërbimet përkatëse.

6.4. Ministria përgjegjëse për arsimin - Drejtoritë Arsimore Rajonale (DAR):

- a. Secila DAR cakton të paktën një punonjës që mbulon çështjet e lidhura me personat përfitues të strehimit social për mbështetjen e integritit të tyre në sistemin arsimor gjithëpërfshirës;
- b. DAR mbështet dhe zbaton rekomandimet për anëtarët e familjeve në nevojë dhe informon pikën e kontaktit për personat që përfitojnë nga programet e strehimit

në ministrinë përgjegjëse për arsimin, si dhe administratorin shoqëror pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ka vendbanimin familja;

- c. DAR garanton ofrimin e kujdesit të veçantë për:
- nxënësit e sistemit të arsimit të detyrueshëm 9 vjecar, që janë anëtarë të familjeve përfituese të një programi strehimi social sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi në fushën e arsimit,
 - nxënësit që pas mbarimit të arsimit të detyrueshëm kanë nevojë për t'u punësuar në mbështetje të familjeve të tyre, për të ndjekur shkolla apo kurse profesionale,
 - fëmijët me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat publike të arsimit bazë me qëllim integrimin e tyre dhe në institucionet arsimore të specializuara përkohësisht deri në sistemimin e tyre në shkolla të zakonshme në të ardhmen,
- d. DAR siguron arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara ose të familjeve që kanë përjetuar dhunë në familje, pjesë e familjeve që përfitojnë strehim social, në njërin nga dy llojet e institucioneve arsimore, të zakonshme ose të specializuara;
- e. DAR garanton që nxënësve me aftësi të kufizuara fëmijëve me aftësi të kufizuara ose të familjeve që kanë përjetuar dhunë në familje, pjesë e familjeve që përfitojnë strehim social t'u sigurohen mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues.

7. Ministrinë përgjegjëse për strehimin, punësimin, arsimimin dhe kujdesin shëndetësor, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, identifikojnë nevojat për trajnime të pikave të kontaktit për personat që përfitojnë nga programet e strehimit si dhe punonjësve të tyre që përfshihen në ofrimin e shërbimeve familjeve që përfitojnë nga strehimi social, me qëllim vlerësimet e situatave për punonjësit e përfshirë në ofrimin e programeve sociale. Ministrinë marrin masa për ofrimin e trajnimeve sa më shpejt sipas identifikimit të nevojave.
8. Ministria përgjegjëse për strehimin, punësimin, arsimimin dhe kujdesin shëndetësor lidhin rast pas rasti, sipas nevojës, marrëveshje bashkëpunimi me objekt caktimin e mënyrës së ndërveprimit të programeve të strehimit social me ato të arsimit, sociale dhe shëndetësore, përfshirë këtu edhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.
9. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore, ministria përgjegjëse për strehimin, punësimin, arsimimin dhe kujdesin shëndetësor për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Financave
dhe Ekonomisë

Ministri i Shëndetësisë
dhe Mbrojtjes Sociale

Ministri i Arsimit, Sportit
dhe Rinisë

RELACION

PËR PROJEKT UDHËZIMIN

PËR NDËRTHURJEN E PROGRAMEVE SOCIALE TË STREHIMIT ME SHËRBIMET SOCIALE TË PUNËSIMIT, ARSIMIMIT DHE KUJDESIT SHËNDETËSOR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektudhëzimi "Për ndërthurjen e programeve sociale të strehimit me shërbimet sociale të punësimit, arsimimit dhe kujdesit shëndetësor" propozohet në zbatim të nenit 12 të ligjit 22/2018, "Për strehimin social", me qëllim ndërthurjen e programeve sociale të strehimit me shërbimet sociale të punësimit, arsimimit dhe kujdesit shëndetësor.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektudhëzimi është në përputhje të plotë me ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", dhe programin politik të Këshillit të Ministrave për sa i përket politikës ekonomiko-sociale të shtetit shqiptar.

Projektudhëzimi nuk është i parashikuar në programin analitik të projektakteve për vitin 2019 miratuar me VKM Nr. 764, datë 27.12.2018 "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019", por ai parashikohet si detyrim ligjor i parashikuar nga neni 12 i ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social".

Gjithashtu, projektakti plotëson kuadrin ligjor të kërkuar nga Strategjia e Strehimit Social 2016-2025 miratuar me Vendimin nr. 405, datë 01.06.2016, të Këshillit të Ministrave. Kjo Strategji nxori në pah situatën reale të strehimit, identifikoi nevojat për të mbështetur këtë sektor në kushtet e reja të reformës administrative-territoriale si dhe diktoi nevojën e një kuadri ligjor të ri.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektudhëzimi "Për kushtet që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme" është një propozim i bazuar në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", përkatësisht në nenin 12. Projektudhëzimi detajon aspekte procedurale të ndërthurjes së programeve sociale të strehimit me shërbimet sociale

të punësimit, arsimimit dhe kujdesit shëndetësor të cilat ofrohen në përputhje me kuadrin legjislativ në fuqi. Në vazhden e projektakteve të tjera zbatuese të këtij ligji, projektudhëzimi plotëson kuadrin ligjor të nevojshëm për zbatimin e ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" dhe ofrimin e rregullave të nevojshme për njësitë e vetëqeverisjes vendore që të mundësojnë fondet e nevojshme për garantimin e një strehimi social sa më të përshtatshëm dhe që plotëson kërkesat e personave në nevojë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektudhëzimi është hartuar në mbështetje të nenit 118 të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social".

- a) *Përputhshmëria e aktit të propozuar me nenin 100, pikën 1 dhe pikën 2 të nenit 118 të Kushtetutës*: Akti i propozuar propozohet në bashkëpunim nga organe kushtetuese (ministri i Financave dhe Ekonomisë, i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë) dhe miratohet po nga ato (ministri i Financave dhe Ekonomisë, i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë), të cilët kanë tagrin të miratojnë këtë akt (neni 100 i Kushtetutës). Bazuar në nenin 12 të ligjit nr. 22/2018, jemi në kushtet e plotësimit të kërkesave kushtetuese të parashikuara në nenin 118 të Kushtetutës për nxjerrjen e akteve nënligjore, sepse: (i) ligji material përcakton organin publik i cili ka tagrin të urdhërojë nxjerrjen dhe miratimin e këtij akti nënligjor (Udhëzim i Ministrave), (ii) ligji i cili shërben si bazë ligjore e aktit të propozuar autorizon në mënyrë të shprehur nxjerrjen e aktit nënligjor (iii) ligji parashikon çështjet që duhen rregulluar si dhe parimet në bazë të të cilave nxirret akti i propozuar.
- b) *Përputhshmëria e aktit të propozuar me qëllimin e dispozitës përkatëse të ligjit, në funksion të propozimit*: Ligji për strehimin social ka të përcaktuar modalitetet që duhet të plotësojë akti sa i takon qëllimit të propozimit. Konkretisht, neni 12 i ligjit nr. 22/2018 parashikon se: "1) Programet sociale të strehimit ndërthuren me programe të tjera të shërbimeve sociale, kryesisht ato të punësimit, arsimimit e kujdesit shëndetësor dhe 2) Ministria përgjegjëse për strehimin dhe ministria e linjës, sipas llojit të shërbimit, hartojnë udhëzim të përbashkët për të caktuar mënyrën e ndërveprimit të këtyre programeve". Ky parashikim adresohet në titull si edhe në përmbajtjen e projektaktit.
- c) Bazuar në këtë parashikim të ligjit, ministri i Financave dhe Ekonomisë, i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë përgjegjës për strehimin, punësimin, arsimimin dhe kujdesin shëndetësor, propozojnë dhe miratojnë aktin.

- d) *Përputhshmëria e aktit me legjislacionin ndërkombëtar*: Akti nuk lidhet drejtpërdrejt me ndonjë akt ndërkombëtar, por në kuadrin e përgjithshëm është përgatitur në përputhje me to.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektudhëzim nuk ka si objektiv të përafrohet me ndonjë akt ligjor të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektudhëzimi propozohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë në kuadër të zbatimit të politikës së qeverisë shqiptare në fushën e strehimit social dhe ndërveprimit të politikave të punësimit, arsimimit e kujdesit shëndetësor me të, me qëllim ofrimin e të gjithë shërbimeve të nevojshme ndaj grupeve në nevojë për strehim social.

Projektudhëzimi është i strukturuar në 9 pika.

Projekti qartëson aspekte procedurale, të cilat përfshijnë sa vijon:

- të gjitha institucionet e ngarkuara me zbatimin e tij caktojnë pika kontakti për këmbimin e informacioneve dhe mbajtjen e kontakteve me qëllim ndërveprimit në kuadër të zbatimit të programeve të strehimit social;
- përdoren të dhënat e bazës së të dhënave në nivel qendror dhe vendor që krijohen sipas nenit 72 dhe 73 të ligjit nr. 22.2018 ‘Për strehimin social’;
- rrjeti i pikave të kontaktit që krijohet, koordinohet nga ministria përgjegjëse për strehimin;
- pikat e kontaktit për personat që përfitojnë nga programet e strehimit social informojnë aktivisht rrjetin sa herë paraqiten nevoja për punësim, arsimim, shërbime shëndetësore të personave që përfitojnë nga programet e strehimit social;
- pikat e kontaktit, sipas përgjegjësive të tyre, aktivisht ndërmarrin veprime të menjëhershme për adresimin e nevojave të personave dhe ushqejnë bazën e të dhënave me informacionin për veprimet që ndërmarrin.

Në vijim, në pikën 6 përcaktohen angazhime konkrete që institucionet e zbatimit të ligjit sipas fushave të përgjegjësisë të ministrive duhet të ndërmarrin. Konkretisht, këto institucione janë: Shërbimi Social Shtetëror që kujdeset për përfitimin nga programet sociale të individëve/familjeve me vëmendje ndaj personave me aftësi të kufizuara duke parashikuar edhe se mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi edhe me subjekte jopublike apo agjenci private punësimi që ofrojnë

shërbime të mbështetjes për shërbime të punësimit; Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor që ndjek zbatimin e rekomandimeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore për aspekte të lidhura me shëndetësinë dhe paketën higjienosanitare; Shërbimi Kombëtar i Punësimit që angazhohet për integrimin e persoanve në tregun e punës përmes përfshirjes së tyre në njërin nga programet e punësimit që zbatohen në vendin tonë; Drejtoritë Arsimore Rajonale për mbështetjen e integritit të tyre në sistemin arsimor gjithëpërfshirës me vëmendje të shtuar ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Pikat 7 dhe 8 parashikojnë që institucionet identifikojnë nevojat për trajnime të pikave të kontaktit për personat dhe ofrimin e këtyre trajnimeve sa më shpejt sipas identifikimit të nevojave. Gjithashtu, ministrinë përgjegjëse për strehimin, punësimin, arsimimin dhe kujdesin shëndetësor lidhin rast pas rasti, sipas nevojës për ndërveprim edhe më efikas mes institucioneve për nevojat e personave që përfitojnë nga programet e strehimit social.

Pika 9 përcakton institucionet e ngarkuara me zbatimin e projektudhëzimit.

Së fundi parashikohet, në përputhje me Kushtetutën, se hyrja në fuqi e aktit është pas botimit në Fletore Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Me zbatimin e këtij projektudhëzimi ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore, ministria përgjegjëse për strehimin, punësimin, arsimimin dhe kujdesin shëndetësor për zbatimin e këtij udhëzimi.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektudhëzim u hartua në bashkëpunim mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) si ministria përgjegjëse për strehimin, si dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe me mbështetjen e UNDP-së, me asistencën e ekspertëve kombëtarë të kontraktuar nga UNDP-ja mbështetur në procedurat e UNDP-së.

Pranë MFE-së u ngrit grupi i punës me anëtarë nga stafi i MFE-së i cili diskutoi intensivisht dhe konsultoi projektaktin paraprakisht me punonjës të ministrive të përmendura dhe entit kombëtar të banesave në takime të vazhdueshme dhe periodike. Draftet e përgatitura u rishikuan disa herë në

takime të përbashkëta të grupit të punës për të pasqyruar në to çdo problematikë të ndeshur në praktikën e deritanishme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social” përcjell kosto shtesë financiare për të gjitha programet, një pjesë e të cilave do të përballohen nga buxheti qendror dhe nga buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore.

Lidhur me kostot institucionale, projektudhëzimi nuk kërkon ndryshim të numrit të të punësuarve pranë njësive të vetëqeverisjes vendore apo institucioneve të qeverisjes qendrore të ngarkuara me zbatimin e këtij udhëzimi.

MINISTËR

Anila Denaj